

VI. ПОСТАПКА ПРИ ОСТВАРУВАЊЕ НА ПРАВАТА

Член 20

Глувите и наглувите лица ги остваруваат правата со овој закон во согласност со Законот за општа управна постапка, доколку со друг закон поинаку не е одредено.

Центарот за социјална работа решава во прв степен.

По жалба против решението на центарот за социјална работа решава Министерството за труд и социјална политика.

Член 21

Правата според овој закон на глувите и наглувите лица им се гарантираат од денот на донесувањето на решението од членот 5 на овој закон.

По добиеното решение глувото лице и наглувото лице имаат право да поднесат барање до центарот за социјална работа за користење и на правото од членот 5 став 1 на овој закон.

VII. НАДЗОР

Член 22

Надзор над спроведување на овој закон врши Министерството за труд и социјална политика.

Инспекциски надзор врши Државниот инспекторат за труд, согласно со закон.

VIII. ПРЕКРШОЧНИ ОДРЕДБИ

Член 23

Глоба во износ од 500 до 700 евра во денарска противвредност ќе се изрече на физичко лице толкувач, ако се утврди дека ги крши должностите при толкувањето, како и службената должност од членот 12 на овој закон.

Член 24

Глоба во износ од 1.500 до 2.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок на правното лице од членот 5 на овој закон, односно глоба во износ од 800 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече и на одговорното лице во правно лице ако не му обезбеди на глувото и наглувото лице толкувач.

Член 25

Пред поднесување на барање за прекршочна постапка Министерството за труд и социјална политика води постапка за порамнување со толкувачот за прекршок утврден со овој закон, а согласно со Законот за прекршоците.

IX. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 26

Сојузот согласно со членот 10 од овој закон во рок од една година ќе обезбеди изучување на знаковниот јазик.

Во рок од шест месеца од влегувањето во сила на овој закон Сојузот ја објавува листата на толкувачите согласно со членот 15 од овој закон.

До објавувањето на листата на толкувачите од членот 15 на овој закон Сојузот на глуви и наглуви ќе ја применува востановената постапка за издавање на документи за толкувач.

Член 27

Институтот за дефектологија, основното и средното училиште од членовите 8 и 9 на овој закон во рок од две учебни години ќе обезбедат изучување на знаковниот јазик.

Член 28

Актот од членот 17 став 2 на овој закон, министерот за труд и социјална политика ќе го донесе во рок од четири месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 29

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

PËR PËRDORIMIN E GJUHËS SË SHENJAVE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet e drejta e përdorimit të gjuhës së shenjave (në tekstin e mëtejshëm: gjuha e shenjave), e drejta e personave të shurdhët dhe gjysmë të shurdhër në gjuhën e shenjave, mësimi i gjuhës së shenjave, interpretuesit të gjuhës së shenjave, detyrat e Lidhjes Nacionale të Shurdhërve dhe Gjysmë të Shurdhëve të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Lidhja"), financimi, realizimi i të drejtave dhe sanksionet për kundërvajtje.

Neni 2

Gjuha e shenjave në pajtim me këtë ligj, njihet si mënyrë plotësisht natyrore e komunikimit e barabartë me komunikimin folës.

Gjuha e shenjave është gjuhë me të cilën në mënyrë të ndërsjellë merren vesh personat me dëgjim të dëmtuar, përkatësisht është mjet natyror për komunikim ndërmjet këtyre personave dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të cilët kanë nevojë për komunikim.

Gjuhë shenjash është sistem gjuhësor vizual-shenjash, i cili nënkupton zbatim, pozitë, orientim dhe lëvizje të caktuar të duarve dhe të gishtërinjve dhe mimikës së fytyrës.

Neni 3

I shurdhët konsiderohet ai person te i cili dëmtimi i dëgjimit është mbi 80 decibela (në tekstin e mëtejshëm: "db") dhe i cili edhe me amplifikator dëgjues nuk mund ta perceptojë të folurit verbal.

Gjysmë i shurdhët konsiderohet ai person te i cili dëmtimi i dëgjimit në veshin më të mirë është prej 25 db deri më 80 db dhe i cili plotësisht ose pjesërisht e ka zhvilluar të folurit verbal.

Në pajtim me dispozitat e këtij ligji, personat e shurdhër dhe gjysmë të shurdhër mund ta realizojnë të drejtën e interpretimit të gjuhës nga gjuha e folur në gjuhën e shenjave dhe nga gjuha e shenjave në gjuhën e folur.

II. TË DREJTAT E PERSONAVE TË SHURDHËT

Neni 4

Personi i shurdhët dhe gjysmë i shurdhët ka të drejtë në përdorimin e gjuhës së shenjave si palë ose pjesëmarrës në procedurat para organeve shtetërore, organeve të vetadministrimit lokal, organeve të jurisprudencës, ndërmarrjeve publike, enteve, agjencive, фондеве dhe institucioneve dhe organizatave të tjera.

Personi i shurdhët dhe gjysmë i shurdhët, përveç të drejtës nga paragrafi 1 të këtij neni, ka të drejtën e përdorimit të gjuhës së shenjave edhe për nevoja të tjera sipas zgjedhjes së tij, nëse shurdhimi paraqet pengesë me rastin e kënaqjes së nevojave të tij, por më së shumti 30 orë në vit.

E drejta nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni zbatohet me realizimin e së drejtës së interpretuesit.

Neni 5

Qendra për punë sociale lëshon aktvendim për realizimin e së drejtës për interpretues.

Qendra për punë sociale i dorëzon aktvendim Lidhjes për realizimin e së drejtës nëpërmjet sigurimit të personave nga lista e interpretuesve.

Neni 6

Qendra për punë sociale mban evidencën e personave të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët të cilëve u janë dhënë aktvendime në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.

Në aktvendimin nga neni 5 paragrafi 1 të këtij ligji përfshihen këto të dhëna për personin e shurdhët:

- të dhënat personale (emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes)
- të dhënat për vendbanimin,
- numri, data e dhënies dhe kohëzgjatja e aktvendimit.

Për aktvendimin e dhënë qendra për punë sociale e informon edhe Lidhjen.

Neni 7

Organet shtetërore, organet e vetadministrimit lokal, organet e jurisprudencës, ndërmarrjet publike, entet, fondet dhe institucionet dhe organizata të tjera, janë të obliguara që personit të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët t'i sigurojnë interpretues me kërkesën e personit të shurdhët ose me obligim zyrtar menjëherë kur personi i këtillë do të dorëzojë aktvendim nga qendra për punë sociale, me çka i njihet e drejta e përdorimit të interpretuesit.

Shpenzimet e interpretuesit nga neni 4 të këtij ligji i kompensojnë organet, përkatësisht institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni.

III. MËSIMI I GJUHËS SË SHENJAVE

Neni 8

Instituti për Defektologji pranë Fakultetit Filozofik organizon mësimin e gjuhës së shenjave nëpërmjet futjes si lëndë mësimore.

Neni 9

Shkolla për arsim fillor dhe të mesëm në të cilën arsimohet fëmija dhe i riu i shurdhët dhe gjysmë i shurdhët, organizon mësimin e gjuhës së shenjave nëpërmjet futjes si lëndë mësimore në pajtim me Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.

Neni 10

Lidhja organizon mësimin e gjuhës së shenjave për qytetarët të cilët dëshirojnë ta mësojnë gjuhën e shenjave.

Lidhja kryen aftësimin e interpretuesve të gjuhës së shenjave nëpërmjet formave të ndryshme edukative.

Personi i cili do të bëjë edukim për mësimin e gjuhës së shenjave është i obliguar që të posedojë certifikatë në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.

IV. INTERPRETUES I GJUHËS SË SHENJAVE

Neni 11

Interpretues është personi i cili personit të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët i interpreton nga gjuha maqedonase e folur dhe gjuha e folur e pjesëtarëve të bashkësive të gjuhës së shenjave, ndërsa personave që dëgjojnë u interpreton nga gjuha e shenjave të gjuhës maqedonase të folur dhe gjuha e folur e pjesëtarëve të bashkësive.

Interpretues është personi i moshës madhore i cili posedon certifikatë dhe është i regjistruar në regjistrin e interpretuesve, të cilin e mban Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Certifikata është dokument publik.

Neni 12

Interpretuesi gjatë punës së tij është i obliguar ta respektojë kodeksin e etikës profesionale të interpretuesve, të mos i shkelë obligimet e interpretimit të drejtë dhe obligimin zyrtar.

Neni 13

Lidhja i kryen këto detyra:

- mban evidencën e interpretuesve të gjuhës së shenjave;
- shpall listën e interpretuesve në shtypin ditor dhe në uebsajdin e Lidhjes,
- miraton kodeksin e etikës profesionale të interpretuesve,
- siguron interpretues për nevojat e personave të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët,
- mban evidencë për kohën e angazhimit të interpretuesve, dhe
- lëshon dhe tërheq certifikatë të interpretuesit dhe mban evidencën e certifikatave të lëshuara.

Neni 14

Mosrespektim dhe shkelja e dispozitave të nenit 12 dhe nenit 13 alineja 3 e këtij ligji, paraqet bazë për tërheqjen e certifikatës së interpretuesit.

Neni 15

Evidenca nga neni 13 alineja 1 të këtij ligji i përmban këto të dhëna të interpretuesit të gjuhës së shenjave:

- të dhëna personale, shkallën dhe drejtimin e arsimimit, vendbanimin dhe numrin e amzës dhe
 - datën dhe numrin e lëshimit të certifikatës.
- Lista e interpretuesve është publike dhe e kapshme për të gjithë qytetarët e interesuar.

Neni 16

Interpretuesi shlyhet nga evidenca:

- në rast të vdekjes së interpretuesit;
- nëse dorëzon njoftim me shkrim se nuk dëshiron më të punojë si interpretues, dhe

- nëse i është tërhequr certifikata për kryerjen e profesionit të interpretuesit në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

Neni 17

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me aktvendim e verifikon shumën e mjeteve financiare për kompensim të interpretuesit me propozim të Lidhjes në bazë të shpenzimeve reale dhe e njëjta shpallet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit për evidencë dhe mënyrën e mbajtjen e tij.

Neni 18

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale për shkak të zhvillimit dhe afirmimit të gjuhës së shenjave, përparimit të saj nga aspekti lingvistik, fonologjik dhe morfologjik, sintaksës dhe standardizimit të saj, me aktvendim formon Komision prej pesë anëtarësh, edhe atë:

- një anëtarë me titull shkencor doktor, me njohjen e gjuhës së shenjave dhe është mirë që i njëjti të ketë përvojë praktike në arsimimin e personale të shurdhër;

- një anëtar nga Fakulteti Filologjik me titull shkencor doktor;

- një anëtar nga Instituti për Defektologji me titull shkencor doktor, me specializim më të ngushtë surdolog, dhe

- dy anëtarë nga Lidhja me njohjen e gjuhës së shenjave, prej të cilëve njëri të jetë person i shurdhër.

Për anëtarët e Komisionit Ministri kërkon mendim dhe propozim nga Lidhja.

Komisioni punët administrative teknike do t'i zbatojë pranë Lidhjes.

Shpenzimet lidhur me punën e Komisionit i bart Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

V. FINANCIMI

Neni 19

Mjetet financiare për organizimin e mësimit të gjuhës së shenjave nga neni 8, 9 dhe 10 të këtij ligji sigurohen nga Buxheti i Republikës.

VI. PROCEDURA GJATË REALIZIMIT TË SË DREJTAVE

Neni 20

Personat e shurdhët dhe gjysmë të shurdhët i realizojnë të drejtat me këtë ligj në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me ligj tjetër nuk është caktuar ndryshe.

Qendra për punë sociale vendos në shkallën e parë.

Për ankesën kundër aktvendimit të qendrës për punë sociale vendos Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 21

Të drejtat personave të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët sipas këtij ligji u garantohen nga dita e miratimit të aktvendimit nga neni 5 të këtij ligji.

Pas marrjes së aktvendimit personi i shurdhët dhe gjysmë i shurdhët ka të drejtë t'i parashtrijë kërkesë qendrës për punë sociale për shfrytëzimin edhe të së drejtës nga neni 5 paragrafi 1 të këtij ligji.

VII. MBIKËQYRJA

Neni 22

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Mbikëqyrje inspektuese kryen Inspektorati Shtetëror për Punë, në pajtim me ligjin.

VIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 23

Gjobë në shumë prej 500 deri në 700 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit interpretues fizik, nëse konfirmohet se i shkel obligimet gjatë interpretimit, si dhe shërbimin zyrtar nga neni 12 të këtij ligji.

Neni 24

Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nga neni 5 të këtij ligji, përkatësisht gjobë në shumë prej 800 deri në 1 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në person juridik nëse nuk i sigurohet interpretues personit të shurdhët dhe gjysmë të shurdhët.

Neni 25

Para parashtrimit të kërkesës për procedurë për kundërvajtje Ministria e Punës dhe Politikës Sociale mban procedurë për barazim me interpretuesin për kundërvajtje të verifikuar me ligj, e në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Lidhja në pajtim me nenin 10 të këtij ligji në afat prej një viti do të sigurojë mësimin e gjuhës së shenjave.

Në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji, Lidhja e shpall listën e interpretuesve në pajtim me nenin 15 të këtij ligji.

Deri në shpalljen e listës së interpretuesve nga neni 15 të këtij ligji, Lidhja e të shurdhërve dhe gjysmë të shurdhëve do ta zbatojë procedurën e vendosur për dhënien e dokumenteve për interpretues.

Neni 27

Instituti për defektologji, shkolla fillore dhe e mesme nga neni 8 dhe 9 të këtij ligji, në afat prej dy vitesh mësimore do të sigurojnë mësimin e gjuhës së shenjave.

Neni 28

Aktin nga neni 17 paragrafi 2 të këtij ligji, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do ta miratojë në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.